



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 786/1 Prot.

Tiranë, më 18.3 /2025

URDHËR

Nr. 468, datë 18.3 .2025

PËR

**PËRCAKTIMIN E KUOTAVE PËR PERSONELIN E MINISTRISË SË MBROJTJES
DHE SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR PËRFITIMIN E KREDISË SË LEHTËSUAR PËR
BLERJEN E BANESËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 64/5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, germës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të vendimit nr. 468, datë 26.7.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës" dhe të vendimit nr. 21, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike, për vitin 2025",

URDHËROJ:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2025, gjithsej 30 (tridhjetë), ndahen si më poshtë vijon:
 - a. 25 (njëzet e pesë) kuota për punonjësit me status ushtarak aktiv;
 - b. 5 (pesë) kuota për personelin civil.
2. Vlerësimi i dokumentacionit të aplikantëve të bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, të vendimit nr. 468, datë 26.7.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës" dhe të vendimit nr. 21, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike, për vitin 2025".

3. Vlerësimi i aplikantëve të bëhet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr. 2 të këtij urdhri, pjesë e pandarë e tij. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta se kuota të përcaktuara, vlerësimi të realizohet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar në tabelën në lidhjen nr. 2.1 po të këtij urdhri, pjesë e pandarë e tij.
4. Në rast se kuotat e përcaktuar në pikën 1/a, nuk ezaurohen brenda pikës **a.** komisioni ja kalon fituesit të radhës në pikën **b.**
5. Në rast se kuotat e përcaktuar në pikën 1/b, nuk ezaurohen brenda pikës **b.** komisioni ja kalon fituesit të radhës në pikën **a.**
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve.
7. Ndjek zbatimin e këtij urdhri sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Tabela Nr.2

Pikëzimi për të punësuarit në Administratën Publike për t'u trajtuar me kredi të lehtësuar për blerjen e banesës për Ministrinë e Mbrojtjes.

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	50
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	50
B	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	35
C	Punonjës që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor.	45
Ç	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër.	40
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	25
A	Punonjës, që i përket kategorisë “familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar.	25
B	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se dy vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	15
C	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se pesë vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	25
1.3	KUSHTET EKONIMIKE	25
A	I përkasin kategorisë së pagës, sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.06.2024, të ndryshuar.	23
B	I përkasin kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1 sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.06.2024.	25
C	I përket kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2 sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave	23

Shënim: Vlerësimi i aplikantit do të bëhet me pikët e grumbulluara në të tre kategoritë 1.1, 1.2, 1.3. Aplikanti do të marrë vetëm një vlerësim për secilën kategori (në rastet kur përfshihet në më shumë se në një shkronjë brenda një kategorie, si vlerësim të asaj kategorie do ti merret shkronja me vlerësimin më të lartë).

Tabela Nr. 2.1

Sistemi i pikëzimit të përcaktuar nga Ministria e Mbrojtjes për kandidatët me pikë të barabarta, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 09.01.2025, "Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike, për vitin 2025".

	KRITERET E PIKËZIMIT	50
1.1	KUSHTE FAMILJARE/SOCIALE	20
A	Punonjës që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar	20
B	Punonjës që kanë tre fëmijë e më shumë	17
C	Punonjës që kanë një deri dy fëmijë	14
Ç	Punonjës që nuk kanë fëmijë	11
D	Kur të dy prindërit janë punonjës/ushtarakë në administratë, dhe për shkaqe të ndryshme njëri nga prindërit ka ndërruar jetë.	20
E	Kur janë prindër të divorcuar dhe aplikanti ka kujdestarinë e fëmijëve.	20
F	Punonjës/ushtarak, prindi i të cilit ka humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës.	20
G	Kategori të tjera që nuk përfshihen në shkronjat e mësipërme	9
1.2	KUSHTET PUNESIMI	15
A	Punonjës që ka deri në 2 vjet i punësuar	5
B	Punonjës që ka 2 deri në 5 vjet i punësuar	10
C	Punonjës që ka mbi 5 vjet i punësuar	15
1.3	KUSHTET/MUNDËSITË EKONOMIKE	15
A	Të ardhura nga paga bruto mujore me pak se 80.000 lekë.	14
B	Të ardhura nga paga bruto mujore 80.000-130.000 lekë.	15
C	Të ardhura nga paga bruto mujore mbi 130.000 lekë	13

Shënim: Vlerësimi i aplikantit do të bëhet me pikët e grumbulluara në të tre kategoritë 1.1, 1.2, 1.3. Aplikanti do të marrë vetëm një vlerësim për secilën kategori (në rastet kur përfshihet në më shumë se në një shkronjë brenda një kategorie, si vlerësim të asaj kategorie do ti merret shkronja me vlerësimin më të lartë).